V E N D I M
Nr.728, datë 19.11.1998

PËR HAPJEN E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR XHUVANI" TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit.
2. Në këtë fakultet bëjnë pjesë degët: anglisht, frëngjisht, gjermanisht.
3. Efektet financiare, që burojnë nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin për vitin 1998.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko